

PLANIFIKIM I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda Abetare	Shkalla E parë	Klasa I-D
Tema mësimore: Prezantim dhe punim i tingullit dhe shkronjës C c. Abetare f.80.		Situata e të nxënit Vëzhgojnë në video projektor filmin për trumcakun (3 min).	
Rezultatet e të nxënit të kopetencave gjuhësore dhe sipas temës mësimore. Përdor fjalorin e duhur për të komentuar figurën e dhënë. Ndjek udhëzimet e dhëna në lidhje me temën. Bashkëpunon pavarësisht prejardhjes dhe nevojave të veçanta, për të realizuar punën e përbashkët. Kontrollon mjetet, materialet dhe kohën që ka për kryerjen e detyrës. Flet për situatën e dhënë në filmin me trumcakun. Njih tingullin dhe shkronjën C,c. Dallon shkronjën C, c në struktura fjalësh, me ndihmën e figurave. Qarkon shkronjën C, c në pozicione të ndryshme të fjalës (nistore, në trup dhe fundore). Shkruan shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit C, c sipas modelit. Ndan në rrokje fjalët e fjalorit dhe formon fjali me to. Lexon globalisht fjalët.		Fjalët kyç Abetare Tingull, shkronjë C, c, fjalor, Elemente të shkrimit. Lexim global.	
Burime: Libri i nxënësit; video projektor, material filmik, figura të ndryshme, etiketa me shkronja, flipcarte me punët e grupeve dhe objektivat e orës sipas temës. Lapsa, fletore, mjete për vizatim, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Art / vizatim / muzikë. Matematikë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënit			
<ul style="list-style-type: none"> ➤ Vëzhgim, hulumtim, bashkëbisedim, kllaster.. ➤ Pune në grupe, demonstrim, pune e drejtuar. 			

➤ Punë individuale.

Organizimi i orës së mësimit

FAZA E PARË: Vëzhgim, hulumtim, bashkëbisedim, kllaster.

Hapi i parë: Udhëzoi nxënësit të vëzhgojnë me vëmendje materialin filmik për trumcakun. Nxënësit të flasin rreth këtij materiali duke e komentuar atë. Tregojnë kuriozitete për trumcakun. Shkruaj në tabelë titullin e mësimit. Paraqes me figurë shkronjën C.



Hapi i dytë: Iu shpërndaj nxënësve figura dhe etiketa me shkronjat e fjalëve të fjalorit dhe kërkoj nga nxënësit t'i emërtojnë duke evidentuar ato që kanë tingullin C, c: Vendosi në kllasterin e bërë në tabelë figurat që kanë tingullin C dhe emërtimin përkatës. Nxënësit qarkojnë dhe tregojnë pozicionin e shkronjës C në këto fjalë.



Hapi i tretë: Nxjerr para klase nxënësit që kanë etiketat me shkronjat e fjalëve të fjalorit, grupohen sipas ngjyrave të etiketave dhe formojnë fjalët. Nxënës nga klasa lexojnë fjalët (të ndihmuar edhe nga figurat përkatëse), analizojnë (sa shkronja ka?, sa zanore ka?, sa rrokje ka?), tregojnë pozicionin e shkronjës C, formojnë fjali me to.



FAZA E DYTË: Punë në grupe, demonstrim, punë e drejtuar.


Hapi i parë.

Ndaj klasën në grupe. Secilit grup i ndaj detyrën që do të kryejë.

Grupi 1. Emërton figurën e maces, qarkon shkronjën C, ndan atë në rrokje, formon fjali me fjalën mace.




Grupi 2. Emërton figurën e këpucës, qarkon shkronjën C, ndan atë në rrokje, formon fjali me fjalën këpucë.



Grupi 3. Emërton figurën e karrocës, qarkon shkronjën C, ndan atë në rrokje, formon fjali me fjalën karrocë.



Grupi 4. Emërton figurat e dhëna, qarkon shkronjën C, ndan atë në rrokje.




Grupi 5. Formon pazëllin. Emërton 4 figura, qarkon shkronjën C, ndan në rrokje fjalët.




Grupi 6. Emërton figurat, plotëson fjalëkryqin.




Grupi 7. Plotëson problemën më të dhënat, zgjidh atë.



Grupi 8. Vëzhgon fjalitë numerike, ngjyros ato me shumën 8. Tregon figurën që formohet.



Grupi 9. Vëzhgon tabelën me shkronja, qarkon vertikalisht dhe horizontalisht fjalë që kanë shkronjën C, lexon ato.





Hapi i dytë. Përgjegjësit e grupit prezantojnë para klasës punën e bërë në grupe. Pjesëtarët e grupeve plotësojnë.





Hapi i tretë.

Paraqes me video projektor faqen 80 të abetares, nxënësit hapin librin në faqen 80. Analizojnë titullin, qarkojmë shkronjën C. Komentojnë figurën e librit. Emërtojnë figurat, qarkojnë shkronjën C. Lexojnë globalisht fjalët. Lexojnë fjalinë dhe fjalët, analizojnë ato. Shpjegoj elemente të shkronjave të shtypit C, c. Disa nxënës modelojnë në tabelë.




FAZA E TRETË: Punë individuale.

Iu shpërndaj nxënësve fletët A4 në të cilën është vendosur figura e maces, të cilën nxënësit do ta emërtojnë. Do të modelojnë shkronjën C të madhe të shtypit dhe c të vogël të shtypit. Në fund të faqes do të formojnë fjali me fjalën “CIRK”.



Vëzhgoj, ndihmoj nxënësit që kanë vështirësi. Lexojnë fjalitë disa nxënës.



Vlerësimi: formues dhe i vazhdueshëm.

Vlerësoj nxënësit për:

Emërtimin e figurave, dallimin dhe shqiptimin e shkronjës C qarkimin e shkronjës C, ndarjen e fjalëve në rrokje, leximin dhe shqiptim saktë të fjalëve, analizën e fjalëve dhe fjalisë, mënyrën si komenton, shkrimin e shkronjës C.

Gjithashtu vlerësoj punën e grupeve duke evidentuar grupet që punuan më shpejt, më saktë dhe më qetë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Katër rreshta me C, c. Nga një rresht me fjalët e fjalorit, formo fjali me këto fjalë. Vizatim i figurave të fjalorit.

Kjo orë mësimore u përgatit nga mësuese Irena Çuçi, shkolla “Emin Duraku”.